PRINDI QËNDRON MBI KREJT BOTËN!

FJALIMI I HFZ. SABRI KOÇIT NË CEREMONINË E RIHAPJES SË XHAMISË SË PLUMBIT - 16.11.90

LETËR VËLLAZËRORE HOXHALLARËVE

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 18 - Nr. 11 (213), Nëntor, 2020

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

"FLAMURI NJEHET SI NJI GJA E SHEJTË PËR TË GJITHË KOMBET!"

PËRUROHET KOMPLEKSI DHE XHAMIA E RE E LAGJES KIRAS

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

"AI QË ZGJOHET I SIGURT NË VETEN DHE FAMILJEN E TIJ,... ËSHTË SIKUR T'I ISHTE DHËNË PASURIA E KREJT BOTËS!"

Të shtrenjtë e të dashtun të zemrës!

Na mëson Resulullahu (a.s), se: "Ai që zgjohet i sigurt në veten dhe familjen e tij, i shëndoshë në trupin e tij dhe, që posedon ushqimin e ditës së tij, është sikur t'i ishte dhënë pasuria e krejt botës!".

Këtë fjalë të madhe, që e kanë regjistruar Imam Buhariu dhe Imam Tirmidhiu, lyspet mos ta harrojmë asnjëherë, duke qenë përherë falënderues e mirënjohës ndaj Zotit tonë, për çfarë na ka dhënë e çfarë na begaton me të çdo ditë!

Biem shëndosh, zgjohemi shëndosh, jemi të sigurt, nuk jemi në luftë a gjendje frike, kemi ushqimin e ditës, kemi harmoni e na qeshin fytyrat duke parë njëri-tjetrin e duke e falënderuar Zotin për çfarë na ka begatuar; pasha Allahun këto ndjesi nuk maten, as peshohen me florinjtë e botës!

Edhe kur biem të sëmurë e zgjohemi në lëngatë, porse nuk e harrojmë Zotin tonë, me durim e lutje e falënderojmë dhe shërim i kërkojmë, prap jemi në një gjendje pëlqimi e razilleku të brendshëm, që veçse i jep njeriut kuptimet e dobësisë e përuljes para Atij, që ka në dorë çdo gjë; edhe lëngatën, edhe shëndetin, edhe dhimbjen, edhe shërimin!

Ta falënderojmë Allahun me të madhe për çfarë na ka dhënë e na jep në çdo moment të jetës, të jemi falënderues e mos të harrojmë, se kjo botë është kalimtare, jo stacioni i fundit, jo qëllim në vetvete, porse amanet, që na është dhënë për ta ndërtuar me anë të falënderimit e mirënjohjes, për t'u kthyer jeta mbi tokë, me kontributin e secilit, në vendin e falënderimit e mirënjohjes!

Allahun e Madhëruar e falënderoj për secilin prej jush; për ngrohtësinë dhe dashninë, me të cilat më bëtë të ndjehem më i pasuri e më i lumturi njeri në botë! Se, çfarë vlere do të kishte jeta në një shoqëri pa dhembshurinë, mëshirën, dorën e sinqertë, lutjen e zemrës, mbështetjen e pakursyer, interesimin e vazhdueshëm, pyetjen dhe interesimin, merakun dhe sikletin, shtyrjen për t'u ngritur edhe më i fortë në këmbë, pas një sprove e vështirësie, që të thyen e të dobëson, pa e ndjerë e kuptuar?!

Allahume, unë jam i paaftë të shpreh mirënjohjen time për miqtë dhe vëllezërit e mi, gjithandej në botë, që në këto ditë që kaluan, ishin në krahun tim, si shfaqje e bekimeve Tua ndaj meje dhe familjes sime!

Të lutem, shpërblimin e merituar t'ia japësh secilit, duke ia shumëfishuar atë me siguri në vetvete e familje, shëndet në fizik e ushqimin e përditshëm, bekim e mirësi prej Teje!

Allahu ju dashtë e ju pastë në mbrojtje!

Ankara, 21 nëntor 2020

KY ËSHTË ISLAMI, KËTA JEMI NE!

Po dëgjoja me kënaqësi e nostalgji një ligjëratë të mbajtur në nëntor të vitit 2016 në Damask, nga dijetari dhe edukatori i urtë, Hafizi i Kuranit dhe i Hadithit, Shejkh Naim El-Arksusi, imam dhe hatib i xhamisë "El-Iman", bashkëpunëtor i ngushtë i Shejkh Shuajb Arnautit, rahmet pastë.

Ligjërata përqendrohej tek modeli i tolerancës së muslimanëve në histori. Natyrshëm, jo i atij modeli anemik, pa ngjyrë, erë e shije, që shpeshherë, qarqe të caktuara përpiqen të na prezantojnë edhe në vendin tonë, nëpërmjet tryezave, tribunave e konferencave pa taban e dinjitet, por toleranca e shëndoshë që buron në Kuran, Hadith dhe në shembullin praktik të njerëzve me dinjitet e krenari islame përgjatë shekujve, sot e deri në ditën e fundit mbi këtë gjithësi.

Në fund të ligjëratës së tij, Hoxha i dashur i drejtohet me një mesazh të urtë sirianëve të shpërngulur në Evropë, për shkak të ndodhive mesjetare që kanë kapluar ato vende të shenjta, sot në mesjetën e shpirtit dhe ndërgjegjes së sëmurë njerëzore.

Kështillat e këtij mesazhi, kam dëshirë t'i ndaj me ju: "A e shihni, o vëllezër, tolerancën e muslimanëve përgjatë historisë, gjë për të cilën dëshmojnë edhe shkrimet e vetë perëndimorëve!

Sepse kjo është cilësi e muslimanit me muslimanin dhe me jomuslimanin! Ajetet kuranore dhe hadithet profetike na e obligojnë këtë, na nxisin drejt saj. Dhe, ja muslimanët, që i zbatuan këto porosi përgjatë shekujve!

Prandaj, me këtë rast, i drejtohemi atyre që kanë emigruar drejt Evropës dhe u themi: Ju jeni ambasadorët e fesë suaj në vendet e Evropës! Ju jeni ambasadorë të vendeve tuaja, prandaj ruajeni moralin e Islamit!

Silluni me njerëzit atje me mirësinë e moralit islam! Tregojuni atyre mirësjelljen e Islamit; të vërtetën në fjalë, besën, përsosmërinë në vepra, nderin, sinqeritetin në punë!

Ruajuni që të dalë prej jush ndonjë fjalë a sjellje, që e dëmton imazhin rrezatues të Islamit! Ruajuni, mos të veproni ndonjë vepër, që i atribuon fesë suaj akuza e dyshime!

Bëhuni thirrës drejt kësaj feje, me moralin tuaj të lartë, me ruajtjen e amanetit, me pastërtinë tuaj, me dlirësinë tuaj, me largimin nga gjynahet dhe prapësitë, me distancimin nga të ushqyerit me pasuri harami!

Bëhuni thirrës drejt kësaj feje duke mos u zhytur me të devijuarit, me praktikimin e rregullave të fesë suaj, që i dini shumë mirë!

Ruajuni, mos të paragjykohet kjo fé e madhnueshme nga veprat tuaja!

Kjo është e vërteta e Islamit tonë, që duhet ta praktikojmë në realitetet tona, në mënyrë që krejt njerëzit ta dijnë se çfarë është Islami: 'Ne nuk të kemi dërguar ty, (o Muhammed), veçse mëshirë për mbarë botët'."

Kjo është Siria me elitat e saj, (edhe në ditët e greminave dhe shkatërrimeve të pashembullta), ky është Islami ynë, sot e përherë, këta jemi ne!

Shkodër, më 26 nëntor 2020

FJALIMI I HAFIZ SABRI KOÇIT NË CEREMONINË E RIHAPJES SË XHAMISË SË PLUMBIT, MË 16 NËNTOR 1990

Vëllezër dhe motra!
Myslimanë, katolikë dhe ortodoksë!
Mbi të gjitha, vëllezër shqiptarë!

Sot kemi gëzimin më të madh, që pas 23 vitesh, të dëgjojmë kënaqësinë më të madhe të zemrës dhe të shpirtit tonë. Iu hapën portat zemrave, që të njohin, të dashurojnë, të respektojnë më të Afërmin e tyre, i Cili është më afër te njeriu sesa ai te vetvetja, Zotin! Lavdi të Madhit Zot, që e ruajti dashurinë e Tij në zemrat tona e nuk na përbuzi! Aq më tepër në zemrat e kësaj rinie që sapo del në jetë pa qenë në kontakt me asgjë, ia ndezi dritën e dashurisë së Tij në zemër e në shpirt.

Sot, po organizojmë këtë ceremoni pranë një monumenti të lashtë, të ndërtuar prej 217 vitesh, e cila (xhamia) mbrohet edhe nga shteti.

Popullin le ta lënë të lirë që të gëzojë atë që i dëshiron zemra. Ashtu siç e ka lënë të lirë njerëzinë edhe vetë Zoti i Madhërishëm, nëse duan të besojnë, nëse duan të mos besojnë.

"Nuk ka imponim në fé", shprehet Kur'ani i Madhërishëm; nuk duhet t'i imponohet askujt, por njeriu duhet ta ketë të kultivuar vetë në shpirtin e tij. Çdo gjë që imponohet nuk ka qëndresë në zemrën e të imponuarit. Dhe ajo që ka mbërritur në zemër, nuk ka forcë që ta shkulë atë, sepse i ka rrënjët të thella.

Jemi të të njëjtit rang. Jemi të së njëjtës familje njerëzore. Dallohemi nga ajo kafshërore. Jemi krijesa më e madhe (më e lartë) në ekzistencë dhe e kemi të qartë se na e shpreh Kur'ani i Madhërishëm ku ndër të tjera thotë e urdhëron Zoti: "Është Ai që për ju ka krijuar çdo gjë që ka në Tokë. Pastaj, i është drejtuar qiellit dhe e ka rregulluar, duke e bërë atë shtatë qiej. Ai është i Dijshëm për çdo gjë."

Pra Zoti është Ai që robin e bëri krijesën më të lartë "Njeriun e bëmë figurën më të përsosur e më autoritare në sipërfaqen e dheut... Dielli, Hëna dhe të gjithë planetët i shërbejnë njeriut, i qëndrojnë në gatishmëri. Hapësira kozmike është e lirë për njerëzit që ta vizitojnë, shohin dhe të kuptojnë se çfarë frytesh e dobish kanë të trashëguara nga fuqia e të Madhit Zot..., pra ky vëllezër është një premtim i mbajtur ndaj të Madhit Zot ... për t'iu falur, lutur dhe për të kujtuar fuqinë e Allahut, sepse Ai është aq i dashur me ne sa është detyrë e jona që t'i falemi Atij.

Ne si myslimanë e kemi detyrë një herë në javë, ditën e xhuma (e premte), ditët e tjera i falim nëpër shtëpitë tona dhe i përgjigjemi marrëdhënieve të punës, sepse puna është ajo që e mban gjallë njeriun. Dhe për këto të mira që marrim nëpërmjet punës, dhe në qoftë se nuk e realizojmë si duhet këtë punë, do të japim llogari përpara të Madhit Zot. Asgjë nuk humb, por pëson transformim dhe ruhet e dëgjohet më vonë.

Falja e xhumasë ka disa kushte dhe ndër to është që duhet të kesh leje të plotë prej autoritetit në pushtet, pra je me abdes e nuk flet për shokun tënd, për vëllain tënd, për motrën tënde, nuk i merr nëpër gojë veprimet e tyre dhe nuk merresh me thashetheme të cilat i dënon Zoti.

"O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgjoni njëri-tjetrin", pra kujdes gojën (gjuhën), madje në qoftë se një njeri ka ndonjë të metë të cilën koha vetë mund ta shtyjë të bëjë gabim nga ana morale, ti duhet t'ia mbulosh e të mos e shfaqësh.

(Përgatiti: **Haxhi Lika**)

“FLAMURI NJEHET SI NJI GJA E SHEJTË PËR TË GJITHË KOMBET!”

Sa bukur është të lutesh e të punosh fort, me krejt dhuntitë e forcat që të ka dhënë Zoti, për pavarësinë e vendit dhe shoqërisë tënde; jo nga pushtimet iluzive e propagandat populiste, sesa nga kolonizimet reale që prekin në thelb tabanin e vlerave, atë të besimit, moralit e detajeve më të imëta të identitetit kombëtar!

Sa vepër e madhe është të ngrihet individi ynë, me tërë forcat që ka, për ta shëruar veten, vendin dhe shoqërinë nga e keqja, me krejt format e prekjet e saj, që përpiqet dita-ditës të forcojë veten e të tjetërsojë imazhin e shoqërisë e vendit, nëpërmjet imazhit të shëmtuar e tjetërsues të madhështisë së simboleve kombëtare e shpirtit të sinqertë, që na nxit ta duam e të punojmë për atdheun e kombin, përtej kufijve të sakrificës!

Sa veprim i madh moral e kombëtar, që meriton bekimet e shpërblimet e Zotit, është kur përpiqemi të ndalojmë të keqen, korrupsionin, manipulimet e tendencat e djallëzuara në jetën e përditshme, që e shkatërrojnë atdheun, njeriun, jetën e perspektivën në këtë tokë të bekuar!

Sa veprim i lavdëruar e sa atdhetar i dëshmuar është ai që nuk përton në çdo çast të punojë për përhapjen e të mirës, dijes, urtisë, harmonisë, vëllazërisë, drejtësisë e vlerave kombëtare në mesin e vëllezërve të tij, pa dallime e diferencime; duke e konsideruar secilin pjesë të shtrenjtë të familjes së madhe kombëtare e njerëzore!

A nuk është koha, që për hatër të ndjesisë sonë kombëtare dhe dashnisë për vendin e tokën, të bashkohemi, duke kthyer mbrapsht e duke refuzuar me të gjitha format legjitime, propagandën dhe demagogjinë që e kanë shkatërruar ditë pas dite vendin e shoqërinë, në një kohë, kur njerëzit struken vorfnueshëm rreth tymnajave të tejskajshme të varfërisë së imponuar nga pamundësia për të dalë nga bataku i këtyre realiteteve (gati-gati migjeniane!?), me të cilat përballen çdo ditë?!

Tashmë, flamuri kombëtar do të mbushë ekranet, sheshet, sfondet e ligjërimeve, duart e fëmijëve e rinisë dhe, natyrshëm kjo është një simbolikë e shënuar që më sjell ndër mend shënimet e vjetra në revistën “Kultura Islame”: “Sikurse gjuha qi asht sheji ma i madh i nji kombi, shej qi danë njenin

popull prej tjetrit, e pa të cilin nuk mund të mendohet nji popull se asht gjallë, ashtu edhe flamuri dallon kombet njenin prej tjetrit.

Si në ditë të soçme ashtu edhe në kohna të vjetra sejcili popull pat flamurin e vet. Flamuri njehet si nji gja e shejtë për të gjithë kombet. Mbasi flamuri paska kaq randsi të madhe, e kenka shej nderi e burrnije, kështu do të jetë edhe për ne flamuri kuq e zi ... “ - (Shkruar nga Veli Hafizi, vit’ i V, nr. 2-3 (50-51), Tetuer-Nanduer, 1943, f.50).

Ndërsa mesazhi i madh i kësaj date, struket në thelbin e vargjeve të poetit tonë të madh kombëtar, Naim Frashëri, që shkruan:

“Të munjam të fluturonja, e të
kisham krahë si ti!
Me gaz të madh do të vinjam
Shqipërisë brenda në gji!
Për me marrë drejt Shkumbinë
edh’ Elbasan e Tiranën
E me ardh ke ti, o Shkodër të shof
Drinin e Bujanën!”

Sot, të gjithë e kemi për borxh kombëtar të punojmë kundër të keqes (në krejt dimensionet e saj) e të bashkojmë duart me këdo që mendon e punon për të mirën e atdheut, flamurit kombëtar e interesit të Shqipërisë e shqiptarëve, si të barabartë në mesin e popujve, plot dinjitet e krenari legjitime!

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, 27 nëntor 2020

DR. SALAHUDIN KEFTARO U PRIT NË NJË TAKIM NGA KRYETARJA E BASHKISË SHKODËR

Ditën e mërkurë, më 4 nëntor 2020, Dr. Salahudin Keftaro, i shoqëruar nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, u prit në një takim kortezie nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër, zonja Voltana Ademi.

Për impaktin e këtij takimi, znj. Ademi shkroi në profilin zyrtar në facebook: “Kënaqësi e veçantë të takohem dhe bashkëbisedoj me Dr. Salahudin Keftaro, një personalitet i niveleve të larta, mendimtar islam i shquar në rang botëror, nxitës dhe përhapës i dialogut ndërfetar, drejtor i Fondacionit Arsimor e Bamirës “Shejkh Ahmed Keftaro”

I shoqëruar nga Myftiu i

Shkodrës Imam Muhamed Sytari, me Dr. Keftaro bashkëndamë shumë opinione për zhvillimet aktuale, për Shkodrën si shembull i shkëlqyer i bashkëjetesës, harmonisë fetare, i njerëzve të punës dhe i vlerave të gjithanshme.”

“E, PAS VËSHTIRËSISË VJEN LEHTËSIMI.”
(Kuran, El-Inshirah:5)

SH.T.Z **ILIR META**, PRESIDENT I SHQIPËRISË

Rihapja, 30 vite më parë, e Xhamisë së Plumbit në Shkodër, është një ngjarje historike për komunitetin mysliman dhe për mbarë popullin shqiptar, që kujton sot një ditë të rëndësishme të rikthimit të lirisë së besimit dhe së drejtës së shprehjes, të mohuara për dekada terrori.

Regjimi totalitar ateist e goditi egërsisht dhe e ndaloi fenë, shkatërroi objektet e kultit, persekutoi klerikë dhe besimtarë, por nuk mundi të mposhte besimin e shqiptarëve te Zoti. Me ndryshimet demokratike, myslimanët shqiptarë rifituan liritë fetare dhe, me në krye udhëheqësin e ndritur Hafiz Sabri Koçi, ringritën nga hiri institucionet e kultit.

Shpreh respektin dhe vlerësimin tim për jetën e veprën, si dhe ju bashkohem lutjeve për shpirtin e këtij kleriku të nderuar e të paharruar, për bashkëpunëtorët e tij, si dhe për të gjithë rininë e qytetarët e Shkodrës, të cilët në 16 nëntor 1990 sfiduan me kurajë diktaturën dhe rikthyen shpresën tek besimtarët.

Frymëzuese do të mbetet përherë lutja e Hafiz Sabri Koçit, i cili edhe pse kaloi një kalvar vuajtjesh në burgjet komuniste për gati dy dekada, nuk bëri kurrë thirrje për hakmarrje, por na mësoi: “O Zot, bëj që të falimentojnë zullumqarët me zullumqarët, njëri me tjetrin, të paguajnë hakun ndërmjet tyre.”

Mirënjohje për të gjithë klerikët myslimanë shqiptarë, simbole të përkushtimit ndaj Atdheut e idealeve kombëtare, vlerave hyjnore e njerëzore, të cilët përgjatë gjithë historisë kanë dhënë, me shumë sakrifica, një kontribut të vyer në drejtim të çështjes shqiptare, lirisë, demokracisë dhe forcimit të shtetit modern shqiptar.

LETËR VËLLAZËRORE HOXHALLARËVE

Dr. Mustafa Cerić,
Reisul-ulema (1993 – 2012)

LETËR VËLLAZËRORE HOXHALLARËVE (TË BOSNJËS)

Të dashurit e mi,

Me leje të reisul-ulemas Husjen ef. Kavazoviq, (Kryetar i Bashkësisë Islame të Bosnje-Hercegovinës), po ju shkruaj këtë letër. Ju nuk më keni borxh asgjë dhe unë nuk ju detyrohem asgjë, përveç dashurisë dhe respektit për misionin tuaj të hoxhës, të cilin po e kryeni. Mision, i cili gjithmonë ka qenë i preferuari im. Nga lindja deri në vdekje, shpirti im ishte dhe do të mbetet shpirt i hoxhës.

Ndoshta kjo për juve nuk do të thotë asgjë, por për mua do të thotë, që të tregoj dhe theksoj se po më mundon nostalgjia për minberin e nderuar dhe mihrabin e shenjtë. Por, kur ju shoh në namazin e xhumasë dhe kur e dëgjoj hytben tuaj, më kaplon dhe më pushton lumturia që ju kemi në mbrojtjen e fesë dhe atdheut. Hutbeja juaj mund të mos i përmbushë gjithmonë pritjet e mia, por unë gjithnjë e kam parasysh se nuk ka qenë kurrë më e vështirë të jesh hoxhë sesa që është sot. Çkado që ju thoni dhe që nuk thoni, për dikë gjithmonë jeni fajtorë!?

Por mos harroni: nuk ekziston ndonjë recetë për sukses, por ekziston recetë për dështim, dhe ajo është që t'i kënaqni të gjithë njerëzit, përkatësisht, ta zhgënjeni ndërgjegjen tuaj. Sepse, gjithmonë ta mbani në mend: emri i nderuar "hoxhë" – është argument i gjallë i fesë dhe moralit. Dhe gjithçka që është e nderuar – është e pastër, dhe gjithçka që është e pastër – është e shenjtë, dhe gjithçka që është e shenjtë – është e paprekshme, dhe gjithçka që është e paprekshme – është enigmatike dhe sfiduese që të pandershmit ta çnderojnë me nder. Dhe nderi është ndërgjegjja juaj e pastër. Nga vjen ajo? Nga brenda apo nga jashtë misionit tuaj të hoxhës? Në fillim ajo ju ofrohet nga Pejgamberi Muhammed (a.s): "Ulematë, dijetarët e muslimanëve, janë trashëgimtarë të të dërguarit të Zotit". Tek ne, "ulematë" janë hoxhallarët, jo si një elitë e shenjtë e paprekshme, por si shërbëtorë të fesë, si roje të traditës dhe roje në vijën e parë të atdheut!

Sigurisht, kjo trashëgimi pejgamberike është e nderuar nga Pejgamberi, është më e nderuara nga të gjithë. Por është, gjithashtu edhe barrë tepër e rëndë për atë që, nuk është i gatshëm ta marrë përsipër, që nuk di ta mbajë mbi vete, i cili nuk di ta ndajë atë me ndërgjegje dhe përgjegjësi me të tjerët. Hoxhallarët janë ushtarë, oficerë të cilëve nuk u jepen grada, por ju merret masa e besnikërisë dhe devotshmërisë ndaj misionit të trashëgimtarëve të pejgamberëve, por gjithashtu, ju imponohet edhe masa e luajalitetit dhe përshtatshmërisë ndaj çdo pushteti, si ndaj atij që ju shfrytëzon për një përdorim, ashtu edhe ndaj atij, i cili ju trajton në mënyrë të pabarabartë.

Ju, të dashurit e mi, me vetëdije ose pa vetëdije, jeni gjithmonë midis këtyre dy mundësive: besnikërisë dhe devotshmërisë ndaj Zotit ose besnikërisë dhe përshtatshmërisë ndaj pushtetit. Këtu nuk ka dhe nuk mund të ketë kompromis, përveç nëse besnikëria dhe përkushtimi ndaj Zotit përputhen me besnikërinë dhe përshtatshmërinë ndaj pushtetit. Por, kjo rrallë herë ndodh, siç janë rrethanat kur të gjithë detyrohemi të mbrohemi nga armiqtë. Ka pasur edhe momente të tilla në historinë tonë, por ato ishin jetëshkurtra dhe u harruan shpejt.

Prandaj, unë them se sot gjëja më e vështirë është të jesh hoxhë. Ju e shihni imoralitetin me sytë tuaj, por nuk guxoni të flisni për të me gjuhë të pastër; ju e dëgjoni gënjeshtrën me veshët tuaj, por kundër saj nuk guxoni ta thoni të vërtetën e qartë; ju e ndjeni se diçka nuk është në rregull, por nuk e keni forcën për të korrigjuar padrejtësinë. Për pushtetin, çfarëdo qoftë ai, nuk ju lejohet të flisni, përveç asaj dhe aq sa pushtetit i duhet që të mbahet ashtu që askujt mos t'i përgjigjet për asgjë. Unë e di, se ju nuk e keni humbur ndjenjën tuaj të besnikërisë dhe përkushtimit ndaj Zotit, por e keni fituar frikën nga politika,sepse ju fajëson për mungesë luajaliteti dhe për papërshtatshmëri kur të flasë ndërgjegjja juaj e hoxhës.

Por mos harroni, ju nuk jeni fajtorë për asgjë dhe nuk keni nevojë të keni frikë nga askush tjetër përveç Zotit! Por ju jeni shënjestra e të gjithë atyre që duan të jeni gjithmonë me ta me çdo kusht, si dhe atyre që nuk mund t'ju arrijnë, sepse të premten ata kohën e kalojnë në kafene. Ata që ju duan gjatë fushatës, duke ju blerë kostume dhe xhybe, nëse fitojnë në zgjedhje, atëherë kjo është vetëm meritë e tyre, ndërsa nëse humbin, atëherë është faji juaj sepse nuk ishit mjaft aktiv në promovimin e politikës së tyre.

Kurse për ata që nuk ju duan sepse këta ju "duan" shumë, ju jeni fajtorë sepse jeni të njëanshëm, sepse nuk i keni mbështetur në luftën e tyre të përgjithshme kundër atyre që fituan përsëri, edhe pse të gjithë u thanë atyre se u kishte ardhur fundi.

Dhe kështu, të dashurit e mi, në pafundësinë e misionit tuaj të përgjegjshëm të hoxhës, në popull dhe për popullin, ju luftoni sot me vetveten dhe përreth jush për të gjetur përgjigjen e duhur për sfidat, të cilat janë shumë më të vështira se sa kanë qenë ndonjëherë. Do të doja t'ju ofroja përgjigjen e duhur për dilemat tuaja të hoxhës, por nëse më lejoni, unë do t'ju ofroj, nga ndjenja e dashurisë dhe respektit për misionin tuaj të hoxhës në popullin tonë, disa këshilla, të cilat mund të mos i miratoni, por mua do të ma lehtësoni, nëse më premtoni se në Ditën e Gjykimit do të dëshmoni se unë këtë ua kam thënë:

(1) Gjithmonë jini të vetëdijshëm për misionin tuaj të hoxhës në shpirt, në zemër dhe mendje, mision të cilin e keni trashëguar nga Pejgamberi, sepse ky është kushti i parë dhe themelor për suksesin tuaj në këtë botë dhe shpëtimin në botën tjetër! Pra, që ta dini dhe të besoni se ju jeni ata që jeni: Hoxhallarë! Edhe Pejgamberit Muhammed (a.s), iu desh të besonte vetë se ai ishte me të vërtetë i Dërguari i Zotit. Pa këtë, (imani) besimi i tij nuk do të ishte i vlefshëm.

(2) Gjithmonë mbani në mend se ju jeni të nderuar dhe të privilegjuar, që në emër të Zotit dhe të Dërguarit të Tij t'u flisni njerëzve nga vendi i nderuar i minberit. Prandaj, ju duhet të peshoni çdo fjalë tuajën, në mënyrë që të arrijë në zemrën e besimtarit. Gjithashtu, secilin prej veprimeve tuaja Zoti dhe njerëzit do ta masin me peshore të veçantë, prandaj, mos bëni asgjë që nuk është në përputhje me fenë dhe moralin, as mos shkoni atje ku nuk e keni vendin. Kurrë nuk do ta harroj një mësim nga një xhematli, të cilin e gjeta duke pjekur raki, i cili me të vërtetë u turpërua, por më paralajmëroi se ai këtë mund ta bënte, por ai mua do të më ndëshkonte nëse unë do ta bëja të njëjtën gjë. ***Xhemati ynë ka dëshirë që hoxhallarët e tyre t'i shohin si udhëzues të mirëfilltë dhe të moralshëm.*** Në vetëdijen e tyre, mëkati i hoxhës është i transmetueshëm, si sëmundja ngjitëse, andaj nuk guxon as të shfaqet e as të përhapet.

(3) Ju nuk jeni murgjër të izoluar, as shenjtorë të gjallë, por jeni shërbëtorë të nderuar të fesë dhe moralit. Ju nuk jeni domosdoshmërisht më të dijshmit, por jeni dhe duhet të jeni më shembullorët në fé dhe në moral. Ruani reputacionin tuaj dhe të familjeve tuaja.

(4) Dëgjoni popullin që ta ndjeni arsyen dhe mençurinë e popullit. Mos harroni, populli gjithmonë e ka mendjen natyrale, të ushqyer nga burimi i pastër, që është më e dobishme se mendja artificiale e disa intelektualëve, të cilët janë ushqyer nga burimi i huaj i shkencës së rreme mbi fatin tonë!

(5) Populli e ka frikën e tij, por edhe shpresën e tij. Mundohuni t'ia zvogëloni frikën, dhe t'ia shtoni shpresën! Shpjegojuani atyre se ai që nuk ka frikë nga Zoti, do të ketë gjithmonë frikë nga jeta, sikurse edhe ai që nuk ka shpresë për faljen e Zotit, gjithmonë do të jetë në një gjendje të pashpresë!

(6) Njerëzit sot, kanë frikë jo vetëm nga korona, por edhe nga mjerimi. Detyra juaj është që me njerëzit ta ndani fatin tuaj, sido që të jetë. Ju nuk jeni as degë që mund të pritet, por as gjethe që do të bie vetë. Ju jeni pemë e fortë në popullin tonë, venat e së cilës janë thellë në tokë, që nga Mehmed Fatihu e deri në ditët e sotme.

(7) Ruani amanetin, nderin dhe identitetin e Bashkësisë Islame! Kultivoni vëllazërinë në fé dhe atdhe! Jini të guximshëm për ta thënë të vërtetën, edhe nëse është e hidhur! Mos e keni zili njëri-tjetrin! Kënaquni me suksesin e vëllezërve tuaj! Ndihmoni vëllanë tuaj në gëzim dhe në hidhërim! Sepse Allahu i Madhërishëm e ndihmon atë që ndihmon vëllanë e tij!

Ju jeni pemë e fortë në popullin tonë, venat e së cilës janë thellë në tokë, që nga Mehmed Fatihu e deri në ditët e sotme.

Secilin prej veprimeve tuaja Zoti dhe njerëzit do ta masin me peshore të veçantë, prandaj, mos bëni asgjë që nuk është në përputhje me fenë dhe moralin, as mos shkoni atje ku nuk e keni vendin.

(8) Në vendin tonë, kurrë nuk kanë qenë kohët e lehta! Por, këto të sotmet janë veçanërisht të vështira. Prandaj, të dashurit e mi, jini vigjilentë dhe të kujdesshëm! Populli po ju shikon juve dhe po e dëgjon fjalën tuaj! Mos i zhgënjeni njerëzit! ***Bëhuni korrigjues të politikës jo korrekte, sepse politika për ne muslimanët, pas gjenocidit, nuk është as zbavitje, as ndeshje rasti, por politika për ne është çështje ekzistenciale, e cila kërkon që të përfaqësohemi nga më të zgjuarit, më të respektuarit, më të aftët, më të drejtët dhe nga ata që më së shumti e duan të vërtetën midis nesh!***

(9) Nëse shihni amoralitet dhe padrejtësi, korrigjojeni me dorën tuaj, e nëse nuk mundeni, atëherë me gjuhë, dhe nëse nuk mundeni as edhe me gjuhë, atëherë të paktën e përbuzni me zemrën tuaj! Por, atëherë dijeni, se edhe ju, edhe të gjithë ne si popull, jemi në nivelin më të ulët të besimit dhe moralit!

(10) Unë nuk do t'ju them se për cilin duhet të votoni! As ju mos ua thoni këtë njerëzve, por tregojuni atyre për cilësitë e ndershme dhe të afta të atyre që duan, munden dhe dinë ta mbrojnë fenë dhe moralin nga korrupsioni, që ta mbajnë kombin tonë të bashkuar dhe ta shpëtojnë shtetin tonë nga armiqtë!

Të dashur hoxhallarë, dua që ta dini se e keni në dispozicionin tuaj shpirtin, zemrën dhe mendjen time për misionin tuaj të nderuar të hoxhës. Mos u frikësoni! Unë kurrë nuk do të rikandidoj për politikë, por dua të mendoj për fatin tonë dhe dua të flas publikisht në mënyrë që të gjithë të mund të më dëgjojnë, si ata që më duan, ashtu edhe ata që nuk më duan! Allahu i Madhërishëm ju ruajt nga çdo bela dhe sprovë, të cilën nuk jemi në gjendje ta kapërcejmë!

O Allah i Plotfuqishëm, na fuqizo që ta bartim dhe përcjellim me sukses trashëgiminë pejgamberike të Pejgamberit (a.s) nëpër vendin tonë dhe në gjithë botën!

O Allah i Gjithëdijshëm, na mëso se shërbimi i fesë dhe moralit është virtyti më i nderuar!

O Allah i Mëshirshëm, hoxhallarëve tanë, bëjua të dashur misionin e tyre të nderuar me kënaqësinë Tënde dhe shpërblimin e xhenetit!

Sinqerisht!

Përktheu:
Miftar Ajdini
(Marrë nga: www.islampress.ch)

PRINDI QËNDRON MBI KREJT BOTËN!

Falënderojmë Allahun (xh.sh) për mirësinë e udhëzimit në Islam! Dhe, prej mirësisë së udhëzimit është që njeriu të pranojë sprovat e jetës me besim të fortë dhe me bindje që çdo gjë në këtë botë kalimtare e ka një përcaktim nga Zoti i gjithësisë, i Cili do që të na lartësojë edhe të na shfaqë dashninë e Tij dhe të na dëshmojë mëshirën e Tij, nëpërmjet sprovave dhe mënyrën sesi ne përballemi me to.

Në krye të herës unë dua që t'ju falënderoj të gjithëve, krye për emër, për lutjet tuaja të panumërta, për mbështetjen tuaj që na keni dhënë gjatë këtyre dy javëve të vështira për familjen tonë. Dua të përshëndes në mënyrë të veçantë hoxhallarët e nderuar, zotërinjtë tanë, të cilët na kanë urdhëruar nga vende të ndryshme, nga qytetet e ndryshme të Shqipërisë, nga Maqedonia e Veriut dh nga Kosova, nga Mali i Zi, si dhe gjithë ju të dashur e të shtrenjtë vëllezër të pranishëm.

Ajo që kam dëshirë për të thënë përpara se të fal xhenazen e të shtrenjtit babës tonë, rahmet pastë, është se sot, më tepër sesa asnjëherë tjetër ne kemi nevojë për t'i rikujtuar njëri-tjetrit hakun e madh që ka prindi në jetën tonë.

Nuk ka dhimbje më të madhe sesa kur ti ndahesh prej prindit! Se ajo është shenjë e dëshmisë së mëshirës së Allahut (xh.xh), dhe ne jemi njerëz; edhe Pejgamberi (a.s) na ka mësuar dhe na ka thënë se në momente të tilla: "Zemra ndjen dhimbje edhe syri loton, mirëpo ne nuk themi, veçse atë që i pëlqen Zotit tonë, të Allahut jemi e tek Ai do të kthehemi''.

Edhe i shtrenjti baba jonë, po e nis këtë rrugëtim; dhe unë jam i bindur se ato hatmet e Kur'anit që janë bërë gjatë këtyre dy netëve, në vende të ndryshme të botës për shpirtin e tij, edhe ato salavate të panumërta, e ato lutje nga gjithsecili prej jush, nuk janë asgjë tjetër, veçse një dëshmi e mëshirës së Allahut (xh.sh) për shpirtin e këtij njeriu, të cilin ju e njihnit si besimtar, si njeri që e ka dashtë Allahun (xh.sh), që e ka dashtë Pejgamberin (a.s), që e ka frekuentuar xhaminë, që ka qenë një njeri me një zemër të madhe dhe një dashamirësi të pashembullt për krejt krijesat e Zotit!

Të shtrenjtë dhe të dashur vëllezër dhe nëpërmjet jush, krejt shoqërisë tonë.

Ne kemi nevojë sot që të kemi në bebe të syrit prindërit tanë, nëse duam që të jemi një shoqëri me taban dhe shoqëri me vlera. Nuk duhet ta lëmë pas dore prindin, sikurse duhet të dhembë zemra kur dëgjojmë nëpërmjet mediave, se këtu apo atje, dikush ka nxjerrë prindin në rrugë, dikush i ka mbyllur derën, dikush i ka thënë një fjalë të keqe, dikush e ka lënduar prindin; la ilahe il'lallah!

Nuk është në natyrën e vlerave të njerëzve fisnikë të keqtrajtojnë prindin. Prindi është dëshmi e mëshirës së Allahut (xh.sh) në jetën tonë të përditshme.

Mbas adhurimit të Allahut (xh.sh) në jetë, kemi respektin dhe dashurinë për prindin! E nëse nuk i respektojmë prindërit sa i kemi, e nëse nuk interesohemi për rehatinë e dashurinë e harmoninë e zemrës së prindërve tanë, sa i kemi, çfarë brezash do të jemi ne për ata që vijnë?! E çfarë shoqërie do të jemi ne? E si do të jenë fëmijët tanë me ne?

Prandaj të dashurit e mi, ky është një apel për gjithsecilin, për çdo pjesëtar të shoqërisë tonë, t'i respektojmë dhe t'i duam prindërit tanë!

Prindin e kemi të shenjtë, e kemi mbi çdo njeri në botë! Tërë bota është në një krah, babai dhe nëna janë në një krah tjetër!

Interesi i askujt në botë nuk vjen para interesit dhe razillëkut të prindit!

Pejgamberi (a.s) na ka mësuar se: "Vështrimi në fytyrën e prindit është adhurim", subhanallah!

Pra, nëse të sheh prindi me sytë e razillëkut ti ke fituar begatitë e kësaj bote edhe të jetës së përtejme.

Allahu (xh.sh) jua shpërbleftë krejtve dhe na bëftë prej atyre që ia dimë hakun vlerave dhe mirësive të Tij dhe që respektojmë hakun e Zotit në jetë!

(Fjala e mbajtur nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, në ceremoninë e faljes së xhenazes së babit të tij, H. Bardhyl Sytari)

Shkodër, më 24 nëntor 2020

KUJDESI SHMANG RREZIQET

Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Në jetën e kësaj bote shumë herë përballemi me rreziqe të ndryshme. Këto rreziqe mund të rrezikojnë shëndetin, pasurinë, familjen madje edhe jetën tonë. Gjithmonë njerëzit e mençur kanë dhënë udhëzime të duhura se si duhet të jemi të kujdesshëm ndaj rreziqeve të ndryshme.

Mënyra më e mirë për të shmangur rreziqet është kujdesi.

Sa herë që njerëzit i kanë dëgjuar të mençurit gjithmonë kanë dalë fitimtarë dhe triumfues. Në momentin kur injorantët janë bërë referencë për të tjerët atëherë njerëzit e kanë pësuar keq.

Një nga dijetarët e hershëm ka thënë: "Njerëzit e mençur, të matur e të formuar duhet të jenë të kujdesshëm në katër fusha. Kujdesi i tyre në këto fusha do të përcaktojë distancën dhe rreziqet e ndryshme mes tyre".

1. Kujdesi në raport me Zotin

Çfarë raportesh kemi me Allahun (xh.sh)? Mbi çfarë baze duhet të ndërtojmë raportet tona me Zotin? Mbi bazën e punëve të mira dhe largimin nga punët e këqija.

Allahu (xh.sh) thotë: "A nuk i mjafton Allahu robit të Vet?!".[1] (robit që ka raporte të mira me Allahun). Çdo rrezik bëhet i pavlefshëm, i parëndësishëm atëherë kur mes nesh dhe rrezikut është Allahu (xh.sh), Mbrojtësi ynë. Para se Ibrahimi (a.s) të hidhej në zjarr tha: "Hasbunallahu ve ni'mel vekil (më mjafton Allahu, Ai është mbrojtësi më i mirë). Allahu (xh.sh) me fuqinë e Tij për hatër të robit të tij dhe raporteve që ai kishte me Zotin e Tij e urdhëroi zjarrin: "O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!"[2]

2. Kujdesi në raport me njëri-tjetrin

Ruajtja e vëllazërimit dhe e solidaritetit mes muslimanëve është detyrë për të gjithë ymetin islam. Allahu (xh.sh) në shumë ajete në Kuran na porositë që të jemi të lidhur dhe të bashkuar me njëri-tjetrin pra të mos përçahemi.

"...mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të dështoni e do t'ju lërë fuqia". [3] Dështimi dhe dobësimi janë të lidhura me grindjen, janë pasoja të përçarjes.

Çdo gjë kalon më lehtë atëherë kur jemi të bashkuar.

T'i rregullojmë raportet me njëri-tjetrin. Nëse kemi gabuar ndaj njëri-tjetrit t'i kërkojmë falje, nëse kemi bërë lëshime t'i përmirësojmë ato lëshime, nëse nuk kemi bashkëpunuar me njëri-tjetrin deri tani të bashkëpunojmë, nëse nuk e kemi respektuar njëri-tjetrin sa duhet ta respektojmë, secili nga ne ka çfarë të shtojë në këtë aspekt.

3. Kujdesi ndaj përgjegjësive dhe llogaritja e vetes vazhdimisht

Vetëllogaria na shtyn në rishikimin e veprimeve dhe punëve që kemi kryer duke na mundësuar që të bëjmë vepra të mira dhe duke na ndihmuar që të shmangim veprat dhe punët e këqija. Ajo e bën njeriun të dallojë atë që është në të mirë të tij dhe atë që nuk është në favor të tij.

Umeri (r.a) ka thënë: "Bëjani llogaritë vetes para se t'ua bëjnë të tjerët. Peshoni punët tuaja sot para se të peshohen tek Allahu (xh.sh). Sot ka vepra e nesër ka llogari, sot ka pendim e nesër ka keqardhje".

4. Kujdesi kur je i vetmuar

Shumë gjynahe bëhen kur njeriu i shpëton syve të njerëzve. Ne kemi frikë dhe largohemi sa herë që e ndjejmë se kamera është drejtuar nga ne. Po ashtu kemi frikë dhe ruhemi nga sytë e njerëzve. Si është e mundur të neglizhojmë dhe të mos ruhemi prej syrit të Atij që na vëzhgon çdo sjellje tonën?! Nga ne lypset që në çdo veprim, të ndiejmë prezencën dhe mbikëqyrjen e Allahut (xh.sh): "Ai është me ju kudo që të gjendeni; Ai sheh gjithçka që bëni".[4] Prandaj ne duhet ta rregullojmë veten tonë në mënyrë që ajo që kemi brenda nesh, të jetë e njëjtë me aparencën tonë.

Ibn Tejmije ka thënë: "Nëse e zbukuron shpirtin, Allahu t'i zbukuron veprat."[5]

Disa nga të parët tanë të mirë kanë thënë: "Me gjithë gjynahet që bëjmë, po na zë dita dhe nata me dhunti të panumërta të Allahut ndaj nesh, nuk e dimë për çfarë ta falënderojmë Atë më përpara, a për të mirat që po na dhuron, apo për të metat që po na i mbulon".[6]

Kujdesi jonë në këto fusha na mundëson që me lejen e Allahut ti rezistojmë të gjitha rreziqeve që mund të na dalin në këtë botë.

1. Kur'ani, Ez-Zumer: 36.
2. Kur'ani, El-Enbija: 69.
3. Kur'ani, El-Enfal: 46.
4. Kur'ani, El-Hadid: 4.
5. Mexhmuu-l-fetava, 3/277.
6. Maverdi në: Edebud-dunja ved-din.

TURQIA
OSE REPUBLIKA E TURQISË

Turqia, ose ndryshe, Republika e Turqisë, është një shtet transkontinental, ku pjesa më e madhe e këtij shteti gjendet në Gadishullin e Anadollit (rreth 97%), në perëndim të Azisë, ndërsa një pjesë e vogël e tij (rreth 3%) gjendet në Gadishullin e Ballkanit, në juglindje të Evropës. Ngushtica e Bosforit, Deti Marmara, si edhe ngushtica e Dardaneleve, bëjnë ndarjen mes pjesës Aziatike dhe asaj Evropiane të Turqisë.

Shteti i Turqisë kufizohet me Detin e Zi në veri, me Gjeorgjinë në verilindje, me Armeninë, enklavën azere Nahxhevān dhe me Iranin në lindje, me Irakun në juglindje, me Sirinë dhe me Detin Mesdhe në jug, me Detin Egje në perëndim, dhe me Greqinë e Bullgarinë në veriperëndim.

Turqia ka një sipërfaqe prej 783,562 km² [1], ndërsa popullsia shkon në 84,711,638 banorë (Nëntor 2020).[2]

Stambolli, një qytet i cili shtrihet në dy kontinente, në Azi edhe në Evropë, është qyteti më i madh në Turqi, ndërsa Ankaraja është kryeqyteti i vendit.

Ngushtica e Bosforit, Deti Marmara dhe ngushtica e Dardaneleve përbëjnë daljen e vetme për nga Deti i Zi, në Detin Mesdhe, dalje të cilën Turqia e ka tërësisht nën kontroll. Kjo përbën një faktor të rëndësishëm për marrëdhëniet e Turqisë me shtetet e tjera.

Shumica e ishujve përgjatë Detit Egje janë ishuj grek, përveç ishujve Gökçeada dhe Bozcāda, që kontrollohen nga Turqia.[3]

KLIMA

Rajonet e ndryshme të Turqisë, karakterizohen nga klima e ndryshme, për shkak të topografisë së parregullt të vendit.

Rajonet bregdetare të Turqisë në kufi me Detin Egje dhe Detin Mesdhe, kanë një klimë mesatare mesdhetare, me verë të nxehtë dhe të thatë, dhe me dimra të freskët edhe të lagësht.

Në Stamboll dhe rreth Detit të Marmaras, klima është e moderuar (dimri 4° C dhe vera 27° C), gjithsesi, në dimër temperaturat mund të bien nën zero.

Anadolli Perëndimor dhe ai Jugor karakterizohen nga klima e butë mesdhetare, me temperatura mesatare prej 9° C në dimër, dhe 29° C në verë.

Rrafshnalta e Anadollit ka një klimë stepash, ku ekziston një ndryshim i madh i temperaturës midis ditës dhe natës. Reshjet e shiut atje janë të pakta, dhe që zakonisht më shumë bien në formë bore. Temperatura mesatare atje është 23° C në verë, dhe -2° C në dimër.

Zona e Detit të Zi ka një klimë kryesisht të lagësht (vera 23° C, dimri 7° C).

Anadolli Lindor dhe ai Juglindor karakterizohen nga dimri i gjatë, ku bora qëndron mbi tokë pa u shkrirë që nga nëntori e deri në fund të prillit. Temperatura mesatare në dimër atje është -13° C, kurse në verë 17° C.[4]

GJUHA

Gjuha zyrtare në vend është turqishtja, e cila flitet si gjuhë e parë nga rreth 86% e popullsisë. Afërsisht 12% e popullsisë flasin dialektin Kurmanxhi (të gjuhës Kurde) si gjuhën e tyre amtare. Arabishtja dhe Zaza janë gjuhët amtare të rreth 2 % të popullsisë në vend, siç fliten edhe disa gjuhë të tjera të cilat janë gjuhët amtare të disa komuniteteve më të vogla atje.

FEJA

Turqia është një shtet laik, që nuk ka një fe zyrtare shtetërore, e kushtetuta turke garanton lirinë e besimit dhe të fesë, por shumica e popullsisë së Turqisë ndjekin fenë islame. Sipas statistikave, Islami është feja e 99.8% të popullsisë së vendit, kurse fetë e tjera, kryesisht krishterimi dhe hebraizmi, janë feja e 0.2% të popullsisë.[5]

EKONOMIA

Ekonomia e Turqisë, siç përcaktohet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, është një ekonomi tregu në zhvillim. Sipas CIA World Factbook, Turqia është një ndër vendet e zhvilluara të botës. Turqia, gjithashtu, përcaktohet nga ekonomistët dhe ekspertët botëror të politikës si një nga shtetet e industrializuara së fundmi. Turqia zë vendin e 19-të në renditje, mes vendeve me Prodhimin e Brendshëm Bruto më të madh në botë, dhe vendin e 13-të në botë për nga fuqia blerëse. Turqia është një ndër prodhuesit kryesorë në botë të produkteve bujqësore, të tekstileve, automjeteve motorike, pajisjeve të transportit, materialeve të ndërtimit, pajisjeve elektronike të konsumit, dhe të pajisjeve shtëpiake.[6]

HISTORI

Historia e turqve përfshin një hark kohor më të gjatë se 4000 vjeçar. Rreth vitit 2000 p.e.s, turqit jetonin në Azinë Qendrore. Më vonë, një pjesë e tyre u larguan nga Azia Qendrore, dhe u përhapën në zonat përreth, në Azi dhe në Evropë, duke krijuar shumë shtete dhe perandori të pavarura nga njëra-tjetra. Këto perandori do të përfshinin Perandorinë e Madhe të Hunëve (e themeluar gjatë shekullit II-të p.e.s), Perandorinë Göktürke (552-740), Perandorinë Ujgure (741- 840), Perandorinë Avare (shekulli 6-9 e.j), Perandorinë Hazar (shekulli 5 -10 e.j), Perandorinë e Madhe Selxhuke (1040-1157), dhe shumë të tjera.

Turqit filluan të vendosen në Anadoll në fillimet e shekullit të 11-të, si pasojë e migrimeve dhe luftimeve të vazhdueshme. Fitorja në Malazgirt (në vitin 1071) kundër Bizantinëve, u hapi portat e Anadollit turqve. Pas kësaj ngjarjeje, turqit e pushtuan plotësisht të gjithë Anadollin, dhe krijuan atje Shtetin Selxhuk të Anadollit (1080-1308). Ky ishte shteti i parë turk në Anadoll, shtet i cili nganjëherë njihej si Sulltanati i Kon'jas, sipas emrit të kryeqytetit të këtij shteti prej shumë vitesh.

Epoka Osmane (1299–1923): Shteti Selxhuk u rrëzua shpejt pas pushtimit mongol të Anadollit (1243). Gjatë periudhës së rënies së Shtetit Selxhuk të Anadollit dhe pas zhdukjes së tij (nga fundi i shekullit të trembëdhjetë), në Anadoll u krijuan shumë principata turke. Njëra nga këto principata ishte edhe Bejliku Osman – Principata Osmane, e emërtuar sipas themeluesit të saj, Osmani i biri i Ertogrulit, që e themeloi atë në vitin 1299, në rrethinat e Söğüt-it (në Eskişehir, në cepin veriperëndimor të gadishullit të Anadollit). Principata Osmane u zgjerua me shpejtësi përgjatë shekullit të 14-të, duke formuar kështu Perandorinë Osmane, e cila sundoi mbi një territor të gjerë, në tre kontinente, dhe që zgjati për 623 vjet, deri në fund të Luftës së Parë Botërore.

Osmanët e morën Kostandinopojën në vitin 1453, gjatë sundimit të Sulltan Mehmetit II (1451-1481). Kjo ngjarje e rëndësishme do të shënonte rënien e Perandorisë Bizantine, e gjithashtu edhe fundin e epokës së Mesjetës, dhe fillimin e Epokës së Re. Gjatë sundimit të Sulltan Mehmetit II, i cili mori titullin "Çliruesi", Shteti Osman hyri në një epokë të zhvillimit të shpejtë, që do të zgjaste deri në fund të shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Në kulmin e sukseseve të këtij shteti, Osmanët sunduan mbi gjithë ato territore ku sot janë Greqia, Bullgaria, ish shtetet e Jugosllavisë, Shqipëria dhe Rumania (në Ballkan), mbi të gjithë ishujt në Mesdheun Lindor, edhe mbi atë rajon që sot njihet si Lindja e Mesme. Kufijtë e Perandorisë Osmane shtriheshin nga Krimeja në veri, deri në Jemen dhe Sudan në jug... dhe nga Irani e Deti Kaspik në lindje, deri në Vjenë në veriperëndim, dhe deri në Spanjë, në Jugperëndim.[7]

ÇLIRIMI I STAMBOLLIT

Marrja e Kostandinopojës konsiderohet nga historianët si një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë njerëzore. Ky qytet kishte qenë gjithmonë në qendër të vëmendjes së myslimanëve. Kjo sepse Profeti (a.s), kishte thënë: "Do ta çlironi Konstandinopojën, dhe sa prijës i mirë është ai prijës, e sa ushtri e mirë është ajo ushtri!" [Imam Ahmed]

Kostandinopoja njihej për bukurinë dhe shkëlqimin e saj, që ngjante me një margaritar të çmuar. Kullat dhe fortesat e atij qyteti lartësoheshin me lavdi!

Në kohën kur Profeti (a.s), u dha lajmin e mirë muslimanëve se ata do ta merrnin Kostandinopojën, ajo ishte një nga kryeqytetet më të rëndësishme të botës, pasi ishte kryeqyteti i Perandorisë Bizantine, perandorisë më të madhe e më të fuqishme të asaj kohe, në duart e të cilëve mbeti për më shumë se dhjetë shekuj.

Marrja e këtij qyteti ishte një gjë krejtësisht ndryshe nga marrja e çdo qyteti tjetër në botë, për shkak të rëndësisë që kishte ky qytet, numrit të madh të fortifikimeve përreth tij, dhe guximit e trimërisë së njerëzve që e zotëronin atë dhe që e mbronin.

Përpjekja e parë e muslimanëve për të marrë Kostandinopojën ishte gjatë sundimit të Muavije ibn Ebi Sufjan, në vitin 49 h (669 e.j). Për t'ia arritur këtij qëllimi, u mobilizua një ushtri e madhe, dhe një numër i madh i sahabëve morën pjesë gjithashtu, përfshirë sahabijtë e njohur Abdullah ibn Omer, Abdullah ibn Abas dhe Ebu Ejub El-Ensari, Zoti qoftë i kënaqur prej tyre. Ishte kjo përpjekje ku sahabiu Ebu Ejub El-Ensari ndërroi jetë, dhe u varros nën muret e Kostandinopojës. Por, kjo fushatë nuk e pati fatin të kishte sukses, për shkak të motit të keq dhe të ftohtë, me të cilin arabët nuk ishin të mësuar asokohe.

Buhariu transmeton se i Dërguari i Zotit (a.s), ka thënë: "Ushtria e parë nga umeti im që sulmojnë qytetin e Çezarit (Kostandinopojën), janë të falur (u falen të gjitha mëkatet)."

Përpjekja e dytë ka qenë në vitin 54 h (674 e.j), dhe rrethimi i qytetit vazhdoi deri në vitin 60 h (680). Gjatë gjithë atyre viteve muslimanët duruan shumë vështirësi, derisa bizantinët i befasuan me një armë të re që muslimanët nuk e kishin njohur më parë, me "zjarrin grek" (një përzierje e squfurit, naftës dhe bitumit), gjë e cila i detyroi ata të hiqnin dorë nga rrethimi i qytetit, dhe të ktheheshin në Damask. Pati edhe përpjekje të tjera... por pa sukses.

Zoti i Plotfuqishëm do t'ua mundësonte këtë fitore muslimanëve pas tetë shekujsh e gjysmë, dhe do të nderonte me këtë një të ri turk me emrin Muhamed, i cili asokohe ishte vetëm 21 vjeç!

Në fakt, për këtë fitore kishin meritat e tyre edhe ata që e kishin hapur rrugën qysh më përpara drejt kësaj, dhe merita më e madhe për këtë i takon komandant Osmanit, djalit të Ertugrulit, i cili e mori pushtetin në vitin 699 h (1299). Rrugën e komandant Osmanit e vazhdoi djali i tij, Sulltan Orhani, i cili mori pushtetin në vitin 726h (1325). Ky kishte marrë Bursën, dhe e kishte bërë atë kryeqytetin e mbretërisë së tij, dhe ishte i pari që e rrethoi Kostandinopojën, por nuk arriti ta merrte.

Bajazidi, i biri i Murad Khan-it I, i cili u ul në fron në 791 h (1389), edhe ky u përpoq ta merrte këtë qytet, por pa sukses. Pastaj Murad Khan-i II, i cili u ul në fron në vitin 864 h (1461), e rrethoi dy herë Kostandinopojën, por edhe këto përpjekjet e tij nuk patën sukses.

Përpjekja e pestë në epokën e Osmanëve, e cila do të ishte edhe përpjekja e fundit, u bë nga i riu Muhamedi II, që ishte Sulltani i shtatë i familjes Osmane. Ushtria që ai drejtonte ishte një ushtri që ngrihej mbi besimin e drejtë dhe që e kishte të qartë konceptin e xhihadit - luftës në rrugën e Zotit. Profeti, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, e pati përmendur dhe lavdëruar atë ushtri shekuj më përpara, gjë e cila tregonte për forcën dhe përgatitjen e saj, por edhe për moralin me të cilin ata karakterizoheshin, dhe për besimin e fortë në fenë islame, pas së cilës ata ishin kapur.

Dita para luftimit vendimtar kishte qenë ditë e hënë, data 20 Xhumada El-Ula, viti 857 h (1453), ditë të cilën Sulltan Muhamedi II, bashkë me ushtrinë e tij, e kishin agjëruar, dhe kur kishte ardhur nata, gjithë natën e kishin kaluar duke falur namaz dhe duke iu lutur me përgjërim Zotit të Plotfuqishëm.

Kur kishte aguar dita e martë, me 20 Xhumada El-Ula, viti 857 h (29 maj, 1453), Sulltan Muhamedi kishte dhënë urdhrin për sulm, dhe Zoti i Plotfuqishëm e kishte shkruajtur fitoren për ta, në atë ditë të paharrueshme!

Pas fitores, Sulltan Muhamedi II e transferoi kryeqytetin e mbretërisë së tij në Kostandinopojë, qytet të cilit ia ndërroi edhe emrin dhe e quajti "Islambol", që do të thotë "Vendi i Islamit".[8]

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

1. www.ar.wikipedia.org/wiki
2. www.worldometers.info/world-population/turkey-population/
3. www.britannica.com/place/Turkey
4. www.web.archive.org/web/20080419130806/http://www.meteor.gov.tr/2006/english/eng-climateofturkey.aspx
5. www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/tu.html
6. www.en.wikipedia.org/wiki/Economy_of_Turkey
7. www.turkishculture.org/general-1067.htm
8. www.alukah.net/culture/0/90347/

BASHKËBISEDIM NË TV1 CHANNEL RRETH LINDJES SË BEGATË TË PEJGAMBERIT (A.S)

Mëngjesin e ditës së hënë, më 2 nëntor 2020, në Tv1 Channel, në emisionin Start të gazetares Linda Kavaja ishte i ftuar teologu Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së "Dy Vajzave" për të folur rreth Lindjes së Begatë të Pejgamberit (a.s) dhe 30 vjetorit të hapjes së xhamisë së Plumbit.

Gjatë bashkëbisedimit me vlerë, teologu Hamja u përgjigj pyetjeve të gazetares rreth personalitetit të Pejgamberit (a.s), ku foli për lindjen, fëmijërinë, rininë dhe periudhën e Shpalljes, kur Zoti i gjithësisë e zgjodhi Muhammedin (a.s), të jetë profeti i fundit dhe vula e gjithë Profetëve.

Ai theksoi, se ashtu si Profetët e tjerë, edhe Profeti Muhammed (a.s) u ndesh me vështirësi, kundërshtime, lëndime dhe persekutime të ndryshme, madje edhe nga njerëzit e afërt të tij, por që përmes durimit, urtësisë dhe mbështetjes hyjnore, arriti të triumfojë mbi të keqën, që kishte kapluar botën atë kohë.



Profeti Muhammed (a.s) arriti, që brenda një periudhe 23 vjeçare të Shpalljes, të transformojë popullin arab, nga një popull i zhytur në injorancë dhe vese të ulëta, në një popull që i dha dritë mbarë botës, përmes përhapjes së mësimeve dhe masazheve të fesë islame.

Ndërsa, për sa i përket 30 vjetorit të rilejimit të besimit, teologu Hamja, tha se, kjo ngjarje e madhe për popullin shqiptar, tregoi se drita e besimit nuk u shua asnjëherë në zemrat e njerëzve, sado ateizmi komunist u mundua ta shuajë atë, por nuk ia arriti.

MYFTIU PRITI DREJTORIN PËR BALLKANIN TË "KOMISIONIT PËR EVROPËN DHE DY AMERIKAT" NGA KUVAJTI

Paraditën e të martës, më 3 nëntor 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, drejtorin për Ballkanin e "Komisionit për Evropën dhe dy Amerikat", në Kuvajt, z. Mahmud En-Nexhdi, që shoqërohej edhe z. Samed Shehu, drejtor i Fondacionit "Mirënjohja".

Gjatë takimit të përzemërt, Myftiu i shprehu mikut të nderuar nga Kuvajti vlerësimet dhe mirënjohjen e tij për kontributet e mëdha që Shteti i Kuvajtit ka dhënë dhe vazhdon të japë në Shkodër e Shqipëri, duke dëshmuar shpirtin e madh të bamirësisë, me të cilin karakterizohet populli kuvajtian.

Njëkohësisht Myftiu falënderoi bashkëpunimin e dëshmuar me fondacionin "Mirënjohja", që bëri të mundur edhe garantimin e projektit për xhaminë e re në lagjen Kiras.

Myftiu dhe z. Mahmud En-Nexhdi diskutuan edhe mbi zhvillimet e fundit, ku dënuan abuzimin që i bëhet imazhit të fesë islame, duke ia faturuar asaj veprimet e dënueshme të dikujt, që përpiqet të shëmtojë imazhin e fesë islame, sidomos në perëndim.

Bashkëristh, ata vizituan edhe xhaminë e re të Kirasit, ku po bëhen edhe punimet e fundit për këtë kompleks të ri islam në qytetin e Shkodrës dhe që së shpejti do të inaugurohet, në kuadër të 30 vjetorit të rihapjes së xhamisë së parë në Shkodër e Shqipërisë.

MYFTIU PRITI MENDIMTARIN E SHQUAR ISLAM, DR. SALAHUDIN KEFTARO

Ditën e mërkurë, më 4 nëntor 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt mendimtarin e shquar islam damasken, Dr. Salahudin Ahmed Keftaro.

Gjatë takimit të përzemërt, Myftiu vlerësoi kontributin e shquar të Dr. Keftaro dhe të Fondacionit Arsimor e Bamirës që mban emrin e Kryemyftiut të Madh të Sirisë, H.T. Shejkh Ahmed Keftaro (1915-2004), në Damask të Sirisë.

Me dhjetëra studentë shqiptarë, kryesisht nga Shkodra, u diplomuan në njërin prej katër fakulteteve islame që menaxhon ky fondacion me famë botërore.

Myftiu e njohu mikun e madh me aktivitetin e Myftinisë Shkodër gjatë këtij viti, që përkon edhe me 30 vjetorin e rihapjes së xhamisë së parë pas 23 viteve të ndalimit me ligj të fesë në Shqipëri.

Nga ana e tij, Dr. Salahudin Keftaro shprehu kënaqësinë e tij për këtë vizitë, sikurse theksoi se gjatë këtyre ditëve të qëndrimit të tij në Shqipëri, ka marrë përshtypjet më të mira në lidhje me aktivitetin e Thirrjes Islame, frymën e besimit e bamirësisë, qytetarisë e vlerave të paqes dhe harmonisë sociale në vend.

Ai theksoi se gjatë takimeve të shumta me imamët, thirrësit, rininë dhe elitat e shoqërisë, vlerësoi se fryma e optimizmit që rrezaton Islami në shoqërinë shqiptare do të jetë një kontribuues i mrekullueshëm për zhvillimin e vlerave më të mira në këtë vend të begatë.

DR. SALAHUDIN KEFTARO MBAJTI HYTBEN E XHUMASË NË XHAMINË E PARRUCËS

Ditën e xhuma, më 6 nëntor 2020, me ftesë të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mendimtari i shquar islam nga Damasku i Sirisë, Dr. Salahudin Keftaro mbajti hytben e xhumasë në xhaminë e Parrucës.

Në krye të herës, Myftiu i Shkodrës e falënderoi mikun e madh nga Damasku i Sirisë, sikurse theksoi se vizita të tilla elitare na ndihmojnë për të qëndruar të lidhur me pjesën tjetër të ymetit islam, si një familje e madhe vlerash, sidomos në këto kohë.

Në hytben e kësaj jave, Dr. Salahudin Keftaro tha se ne gjendemi në një muaj të begatë, në të cilin përkujtojmë lindjen e begatë të Hz. Muhammedit (a.s), që u dërgua me misionin e mëshirës për mbarë botët!

Ai tha se përkujtimi i kësaj lindjeje të begatë nuk ka vlerën e përkujtimit të lindjes së trupit, sesa atë të një misioni hyjnor që erdhi për të përhapur mëshirën në mesin e njerëzve.

Ai bëri thirrje që besimtarët të ndjekin gjurmët e Pejgamberit (a.s) duke ripërtërirë mesazhet e mëshirës dhe humanizmit në jetë.

Njëkohësisht theksoi se sot, ne po përballemi me sfida të ndryshme, si ato të denigrimit të fesë dhe besimit, Pejgamberit dhe Islamit në tërësi dhe se në këtë kontekst, edhe ne muslimanët kemi hisen tonë të fajit, pasi nuk kemi ditur ta prezantojmë si duhet mesazhin e të Dërguarit të Allahut në jetë!

Gjatë hytbes së mbajtur në xhaminë e Parrucës, Dr. Keftaro tha se para 15 shekujsh, Hz. Muhammedi (a.s) e quajti tokën si Nënë, duke na mësuar për t'u kujdesur maksimalisht për të dhe cilësinë e jetës mbi faqen e dheut.

"Kur ndërtojmë dhe shpikim bomba dhe raketa të ndryshme që sjellin dëme edhe për ekosistemin, për kë shpiken këto bomba, kujt i shërbejnë, për të vrarë kafshët e egra në pyll apo për të vrarë njeriu vëllaun e tij njeri?

Edhe toka do të ankohet për këtë njeri shkatërrimtar të saj!

Tashmë që ndodhemi në mes të shumë sfidave, unë i lidhi duart e mia me duart tuaja, sepse ju jeni elita e besimtarëve në zemër të Evropës dhe lutem që ta prezantoni Pejgamberin dhe të dëshmoni vlerat dhe kulturën tonë të madhe.

Ne nuk kemi për qëllim që duke kërkuar që të tjerët të pranojnë Islamin, të dhunojmë të tjerët, sepse përndryshe do kishim thyer urdhrin e Zotit!? Ne jetojmë në një botë, ku ka diversitet, që i ngjan një buqete me lule, ndërsa ne jemi të ftuar të jemi si trëndafili me erë të mirë në këtë buqetë të madhe!" -, tha ndër të tjera Dr. Keftaro.

MBYLLET CIKLI "ÇFARË FITOI BOTA ME ARDHJEN (DËRGESËN) E HZ. MUHAMMEDIT (A.S)"

"Përhapni prej meje, qoftë edhe një fjalë..!"

(Hadith profetik)

«بلغوا عني ولو آية»

H. Durim Kasemi


H. Idmir Plaku

H. Gilman Kazazi

Me rastin e Lindjes së Begatë të Hz. Muhammedit (a.s) dhe 30 vjetorit të rihapjes së xhamisë së Plumbit, Myftinia Shkodër organizoi ciklin e ligjëratave me temë: "Çfarë fitoi bota me ardhjen (dërgesën) e Hz. Muhammedit (a.s)".

Nga data 28 tetor 2020 dhe deri më 6 nëntor 2020, çdo ditë pasdite, në orën 17.00, nga profili zyrtar i Myftinisë Shkodër në facebook, ndjekësit e rrjeteve sociale, patën mundësi të ndiqnin ligjëratat e imamëve dhe teologëve, të cilën trajtuan me korrektësi dhe kompetencë temat të ndryshme rreth jetës dhe moralit të Hz. Pejgamberit (a.s), si dhe vlerave të besimit islam.

Gjithashtu, këto ligjërata të dobishme dhe me vlerë, mund të ndiqen edhe në vazhdim, nga profili në facebook: www.facebook.com/FaqjaZyrtare.MyftiniaShkoder

H. Naim Drijaj

H. Adem Pizga

H. Fejzi Zaganjori

H. Ervil Kuçi

H. Adil Cukali

H. Lavdrim Hamja

H. Ruzhdi Plangaj

MEJTEPI I IM... XHAMIA ZUES

PAK HISTORI:

- Xhamia Zues, ndodhet në Njësinë Administrative Rrethina, zona Shkodër.

- Zuesi përbëhet prej rreth 200 familjeve myslimane. Familjet më të njohura në Zues janë: Vataksi, Hardaj, Haxhimani, Fakaj, Velia (Mehja) etj.

- Xhamia është ndërtuar në vitin 1995. Ndërsa pas disa viteve xhamia është rikonstruktuar tërësisht si dhe njëkohësisht është ndërtuar minarja dhe mejtepi i ri, për bri xhamisë me financimin dhe bamirësinë e Haxhi Osman Vataksit.

- Pas rihapjes së xhamive dhe lirisë fetare, nga viti 1995 e deri më sot kanë shërbyer si imamë dhe mësues feje: Qazim Mehja (imami aktual), Nadi Braqi, Ramazan Avxhe, Indrit Cani, dhe mësuesja aktuale Kimete Elezi

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 13 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002 -2020 është rreth 220 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në vazhdën e programit për zhvillimin e vizitave dhe takimeve me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset-mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni organizoi takimin e radhës, më 7 nëntor 2020 me nxënësit e kursit fetarë në xhaminë Zues.

Drejtuesi i arsimit u mbajti një bisedë nxënësve, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin si përçimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, teologu Halluni foli edhe për respektimin e rregullave gjatë procesit mësimor kundër përhapjes së covid-19, si dhe evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi dhe imami Qazim Mehja, si dhe mësuesja Kimete Elezi.

U FAL XHUMAJA E 30 VJETORIT TË RIHAPJES SË XHAMISË SË PLUMBIT

Ditën e xhuma, më 13 nëntor 2020, në përkujtim të 30 vjetorit të rihapjes së xhamisë së Plumbit, ditës së paharruar të 16 nëntorit 1990, Myftinia Shkodër organizoi faljen e xhumasë përkujtimore të kësaj dite në xhaminë e Plumbit.

Besimtarë të shumtë të ardhur enkas për të falur xhumanë dështuan përmallimin e tyre për këtë xhami dhe mesazhin e paharruar të asaj dite dhe ngjarjeje historike për Shkodrën dhe mbarë Shqipërinë.

Hytbeja e kësaj xhumaje u mbajt nga Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili ndër të tjera theksoi se: "Është bërë traditë, tashmë, mbajtja e hytbes në vendin ku u mbajt "hytbeja e lirisë" 30 vite më parë, në ditët e para të rikthimit të lirisë së besimit në Shqipëri."

Një nga përbërësit më të rëndësishëm të lirisë së njeriut, është liria për të besuar, theksoi Kryetari Spahiu. Ai i bëri thirrje rinisë për të rritur shkallën e njohjes së të shkuarës, me qëllim që ajo të mos përsëritet më kurrë, në të sotmen, as në të ardhmen!

PËRUROHET KOMPLEKSI DHE XHAMIA E RE E LAGJES KIRAS

Ditën e diel, më 15 nëntor 2020, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Fondacionin "Mirënjohja", në prani të shumë besimtarëve, përuruan kompleksin dhe xhaminë e re të lagjes Kiras.

Në këtë ceremoni merrnin pjesë autoritete fetare dhe civile, si dhe besimtarë dhe besimtare të shumtë, që kishin ardhur të merrnin pjesë në këto momente gëzimi.

Këtë ceremoni përurimi e përshëndeten dhe mbajtën fjalën e tyre, sekretari organizativ i Myftinisë Shkodër, teologu Lavdrim Hamja, i cili uroi edhe në emër të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili ndodhet në Turqi për arsye shëndetësore, nënkryetari i KMSh-së, z. Taulant Bica, kryetarja e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi dhe drejtori për Ballkanin i "Komisionit për Evropën dhe dy Amerikat" në Kuvajt, Shejkh Mahmud En-Nexhdi.

Pas ceremonisë, u fal edhe namazi i drekës me xhemat.

MYFTIU I SHKODRËS MORI PJESË NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE ONLINE TË INDISË

Ditën e xhuma, më 13 nëntor 2020, me ftesë të Kryemyftiut të Indisë, H.T. Shejkh Ebu Bekr Ahmed, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në konferencën ndërkombëtare online, që u zhvillua nga Universiteti 'Jamia Markazu Saquafathi Sunniyya Al Islamiyya'.

Në këtë konferencë, ku morën pjesë dijetarë dhe mendimtarë të shquar të botës islame nga lindja e perëndimi, Myftiu i Shkodrës u prezantua me punimin e titulluar: 'Si të jetojmë krenarë me Islamin tonë!'.

Ndër të tjera, Myftiu theksoi se realitetet e sotme botërore po na ftojnë përherë e më tepër drejt bindjes së palëkundur se ky Islam dhe udhëzimi i Hz. Muhamedit (a.s), janë një alternativë e pashmangshme për tejkalimin e krizës së qytetërimeve materiale, që jetojnë sot në kllapinë e degradimit dhe paaftësisë për të drejtuar njerëzimin drejt vlerave të pretenduara.

MYFTIU LIGJËROI PARA NJË GRUPI STUDENTËSH NË ANKARA

Me ftesë të *Asma Köprü Uluslararası Öğrenci Derneği*, ditën e diel, më 22 nëntor 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ligjëroi rreth temës: "Ndërtimi i elitave në jetën e Resulullahut (a.s), në mesin e një grupi studentësh në Ankara.

Sipas postimit të bërë në profilin e tij zyrtar, Myftiu shkruan: "Me ftesën bujare të *Asma Köprü Uluslararası Öğrenci Derneği* zhvillova mbrëmë një bashkëbisedim të ngrohtë rreth zhvillimit të komunitetit të elitave në jetën e Resulullahut (a.s), në mesin e kërkuesve të dijes dhe studiuesve të zellshëm, që punojnë dhe veprojnë me dëshirë e përkushtim të madh për të mirën e dijes, shoqërisë dhe njerëzimit!

Janë mahnitëse tekstet e shumta kuranore dhe shembujt e gjallë në jetën e Pejgamberit tonë (a.s) në drejtim të zhvillimit të një shoqërie të shëndoshë elitare, ku secili ndjek dritën drejt së cilës është thirrur nga Zoti në jetë, duke dëshmuar fetarizmin e shëndoshë në shërbimet e tij ndaj jetës, shoqërisë dhe dobisë për njerëzimin, pa u ndalur tek detaje të papërfillshme, që zakonisht angazhojnë modele dekadente shoqërishë të keqformuara fetarisht dhe të abuzuara nga keqleximi që i bëhet çdo ditë fesë, gjithandej nëpër botë.

Theksova se muslimani është njeri i kohës, besimtar i thellë, i përkushtuar maksimalisht ndaj dijes dhe i ftuar për të bërë mirë në çdo fushë të jetës, në atë mënyrë që të spikasë me arritjet e tij dhe të dëshmohet me gisht për kontributet e tij të sinqerta!

Konfirmova faktin se muslimani nuk e njeh pesimizmin dhe thyerjen në jetë dhe se, me punën dhe përkushtimin e tij, ai jep çdo ditë një kontribut të heshtur për pastrimin e mjedisit shoqëror nga 'këngët e kukuvajkave' që ndjellin mjerim e pesimizëm shkatërrimtarë të moralit dhe psikologjisë së masave!

Ky takim më fali energji pozitive, sikurse më gjallëroi pas bekimit të madh, me të cilin Zoti i gjithësisë më risolli në jetë, pas një sprove të papërshkrueshme shëndetësore.

Sipas drejtuesve të saj, Asma Köprü Uluslararası Öğrenci Derneği është një organizatë e themeluar prej vitesh dhe me mbështetjen e popullit turk, ajo kujdeset për studentët e huaj që vijnë për të studiuar nëTurqi, veçanërisht në Ankara.

Aktualisht në Ankara, kryejnë studimet rreth 14000 studentë në fusha të ndryshme të dijes, të ardhur nga 130 shtete të botës.

Në thelb, Asma Köprü, synon që këtyre studentëve t'iu gjendet pranë gjatë kohës së studimeve dhe qëndrimit të tyre në Ankara".

MYFTINIA SHKODËR URON 108 VJETORIN E DITËS SË FLAMURIT

Ditën e shtunë, më 28 nëntor 2020, përfaqësues të Myftinisë Shkodër, H. Fejzi Zaganjori dhe teologu Lavdrim Hamja, morën pjesë në ceremoninë e ngritjes së flamurit kombëtar, të organizuar nga Bashkia Shkodër.

Në këtë ceremoni merrnin pjesë autoritete lokale dhe fetare. Pas përshëndetjeve të rastit, nga përfaqësuesit e pushtetit lokal, komunitetet fetare bënë një lutje të përbashkët nën drejtimin e H. Fejzi Zaganjorit, duke u lutur për shpirtrat e firmëtarëve të Pavarësisë dhe dëshmorëve të kombit, të cilët sakrifikuan çdo gjë, për këto troje dhe këtë vend të bekuar.

Myftinia Shkodër, uron mbarë shqiptarët, kudo që ndodhen: Gëzuar 108 vjetorin e Ditës së Flamurit, ditës së Pavarësisë së kombit shqiptar!

UNESCO SHPALL 18 NËNTORIN "DITA E ARTEVE ISLAME"!..

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO) e ka shpallur 18 Nëntorin si "Ditën ndërkombëtare të arteve islame".

Në deklaratën me shkrim të bërë nga UNESCO thuhet se mbështetur në vendimin e marrë në Konferencën e 40-të të Përgjithshme, 18 Nëntori do të festohet çdo vit si "Dita ndërkombëtare e arteve islame" dhe kjo ditë synon të rrisë ndërgjegjësimin në lidhje me aspektin artistik të Islamit dhe kontributin e kulturës në civilizim përmes artit islam.

"Dita ndërkombëtare e arteve islame" do të nxisë interesin ndaj artit islam që frymëzon lëvizje të tjera artistike dhe do të inkurajojë afrimin ndërkulturor. Festimi i 18 Nëntorit në të gjithë botën do të kontribuojë gjithashtu edhe në diversitetin kulturor, lirinë e shprehjes, në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe komunikimit ndërkulturor", theksohet në vijim të komunikatës së UNESCO-s.

Mihrabi dhe minberi i xhamisë Umevite, Damask - Siri

UNESCO fton të gjithë të kontribuojnë në "Ditën ndërkombëtare të arteve islame".

Drejtori i përgjithshëm i UNESCO-s, Audrey Azoulay theksoi se artet islame janë në proces rinovimi dhe ndikojnë të gjitha kulturat në botë.

Duke vënë në dukje se ata shpallën këtë ditë [18 nëntorin] si "Ditën ndërkombëtare të arteve islame" për të festuar këtë trashëgimi të jashtëzakonshme të shtrirë në 14 shekuj, Azoulay vuri në dukje se historia e arteve islame duhet të njihet më mirë.

(www.radiojehona.al)

Dr. Mustafa Mahmud

Islami triumfon, pushton zemrat dhe përhapet në çdo cep të botës, bile në zemër të Parisit, Londrës, Njujorkut...

"Më pyesin: Përse gjithë ky besim se Islami do të triumfojë me gjithë prapambetjen e myslimanëve, përçarjen e tyre, varfërinë, poshtërimin dhe injorancën e tyre...

Me gjithë se ata janë pa shpata, pa fuqi, pa mbështetje dhe pas gjithë kësaj errësire të thellë, në të cilën nuk duket asnjë fije drite?

U them: Po ...

Shpata e Islamit tani është e thyer, myslimanët janë të prapambetur, të padijshëm, të varfër dhe të përçarë, por me gjithë këtë...

Dhe me gjithë këtë Islami triumfon, pushton zemrat dhe përhapet në çdo cep të botës, bile në zemër të Parisit, Londrës, Njujorkut...

Çdo ditë njerëz të huaj, u drejtohen imamëve të xhamijave ku u kërkojnë të bëhen myslimanë, të mësojnë shtyllat e Islamit.

Kështu me thjeshtësinë e tij Islami ka sekretin hyjnorë, ka pushtet në vetvete dhe kjo i bën armiqtë e tij të armatosur deri në dhëmbë të dridhen prej tij nga frika dhe ta bëjnë hesap 1000 herë.

Vrasja e myslimanëve, o vëllezërit e mi, është diçka tjetër që nuk do të thotë absolutisht vrasje e Islamit. Dhe, myslimanët, pjesa më e madhe e tyre me të vërtetë janë të vdekur dhe ajo e reja është se vdekja e tyre bëhet e ditur.

Kjo është diçka anësore, sepse kujt i vdes Islami në zemrën e tij, ai nuk numërohet prej myslimanëve, ndërsa kujt i jeton Islami në zemrën e tyre, për ta nuk duhet të frikësohemi, sepse nuk ka pushtet në botë që mund t'i dëmtojë.

(Marrë nga libri "Islami në hendek")

PËRSE NDALOHET MARTESA E MUSLIMANES ME JOMUSLIMANIN?



Prof. Dr. Ali Xhumua,
Ish Myfti i Egjiptit (2003 – 2013)

Martesa është çështje e shenjtë, që do të thotë se Zoti është Ai që i përcakton kushtet dhe rregullat e saj. Martesa është e shenjtë jo vetëm në Islam por në të gjitha fetë.

Nuk janë vetëm muslimanët që thonë se nuk lejohet martesa e muslimanes me jomuslimanin, edhe të krishterët thonë kështu, edhe ata thonë se nuk lejohet martesa e krishteres me muslimanin, por jo vetëm. Ata shkojnë edhe më larg saqë nuk lejojnë as martesën ndërmjet fraksioneve të tyre. Pra, një vajzë protestante nuk martohet me një katolik dhe anasjelltas. Kështu është edhe tek hebrenjtë.

Pra, martesa në esencë është çështje që i përket Zotit. Pse nuk bën të martohemi me hallën apo tezën? Sepse Allahu ka dashur kështu. Përse nuk bën të martohemi me nënën dhe motrën e qumështit? Me to nuk kemi kurrfarë afërsie gjaku, mirëpo Allahu është Ai që e ka ndaluar martesën me to.

Në legjislacionet e kaluara, martesa me hallën ka qenë e lejuar. Nëna e Musai (a.s) ka qenë halla e babait të tij, Imranit. Pra, Imrani është martuar me hallën e vet sepse atëherë ka qenë e lejuar. Prandaj duhet ta kuptojmë një herë e përgjithmonë se martesa tek tri fetë monoteiste është çështje që i përket Zotit. Në krishtërizëm thuhet se këto janë sekrete të kishës. D.m.th rregullat e martesës i ka vendosur Zoti dhe kjo sipas tri feve monoteiste.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: "Për secilin prej jush, Ne caktuam ligj e program (të posaçëm në çështje të veprimit)." Pra, e vërteta e martesës është se rregullat e saj i vendos Allahu e jo njeriu. Njeriu nuk guxon të thotë se kjo është hallall e kjo haram. Ku është dallimi ndërmjet deles e cila ka ngordhur dhe deles e cila është prerë në fyt? Të dyja janë të ngordhura. Por, Allahu e ndaloi të parën kurse e lejoi të dytën. Pastaj pse Zoti e ndaloi derrin? Dëgjojmë disa njerëz duke thënë se Zoti e ndaloi mishin e derrit për shkak së ngrënia e tij shkakton krimba në zorrë..!! Jo, ky mendim është i gabuar sepse ne shohim shumë njerëz në Perëndim që e konsumojnë derrin dhe nuk ju ndodh asgjë e keqe, bile edhe e konsiderojnë si pasuri të atij vendi.

Një gjerman i cili studionte ekonominë këtu në Egjipt, na pyeste neve përse nuk e konsumojmë dhe kultivojmë derrin? A e dini se sa përfitime ekonomike sjell mishi i derrit - thoshte ai. Allahu e ka bërë të ndaluar - ishte përgjigjja jonë, mirëpo atij nuk i interesonte hallalli dhe harami por vetëm përfitimet materiale dhe kënaqësia e kësaj bote.

Atëherë themi kështu: Allahu është Ai që na ka krijuar dhe dëshiron që ne të arrijmë lumturinë dhe kënaqësinë në të dy botët, e jo vetëm lumturinë dhe kënaqësinë e kësaj bote. Allahu na ndaloi disa gjëra në këtë botë (e që urtësinë e vërtetë të ndalesës e di Ai), por duhet ta kuptojmë se jeta në këtë botë nuk është përfundimtare. Kjo jetë është e shkurtër, disa sekonda, kurse jeta e Ahiretit është e përhershme dhe e pafund. Allahu na ka krijuar në këtë tokë që të na sprovojë dhe testojë. Na tregoi rrugën e drejtë dhe na dha mendje (intelekt), pastaj kush të dojë le të besojë e kush të dojë le të mohojë.

Për fund, e përsëris edhe një herë se rregullat e martesës janë të vendosura nga i Madhi Zoti, Atij i qofshim falë!

Përktheu:
H. Enes Koshi
Rebstein, Zvicër

16 NËNTOR 2020 / 1990

DITA E RIMËKËMBJES ISLAME

30 VJET NGA RIHAPJA E XHAMISË SË PLUMBIT

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek